**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 831/11 prot                                                                 Datë 31.05.2023

**V E N D I M**
**Nr. 445/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 31.05.2023, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt**:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Malvina Visoka" PF në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-56894-01-25-2023 me objekt "Blerje materiale pastrimi" me fond limit 39 999 986 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) Leke, pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "*Pastrime Silvio*" SHPK në procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur"* me Nr. REF-*56894-01-25-2023,* me objekt "*Blerje materiale pastrimi"*, me fond limit 39,999,986 (*tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e*

*nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "*W. Center*" SHPK në procedurën e prokurimit *"Procedurë e Hapur"* me Nr. REF-*56894-01-25-2023,* me objekt "*Blerje materiale pastrimi",* me fond limit 39,999,986 (*tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

**Ankimues:**

"Malvina Visoka" pf
Dajt Linzë, Rruga "Muhamet Veliu", Pallati Iliad, Shkalla 1, kati , Tiranë.

"Pastrime Silvio" SHPK
Adresa: Rruga "Fatmir Haxhiu", Pall. 2, Shk. 10, Ap. 76, Tiranë.

"W. Center" SHPK
Adresa: Rruga "Dritan Hoxha", Pallati "Teknoprojekt", Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike
Rruga "5 Maji" , Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të

Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre (3) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.01.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-56894-01-25-2023, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 39,999,986 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

II.2. Në datën 23.03.2023 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 07.04.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

| | | |
|---|---|---|
| 1. | "Biotek " SHPK | pa ofertë |
| 2. | "I&V" SHPK | pa ofertë |
| 3. | "Euromega 2010" SHPK | 29.500.354 lekë skualifikuar |
| 4. | "W.Center" SHPK | 35.426.222 lekë skualifikuar |
| 5. | "Anbin" SHPK | 30.474.611 lekë, skualifikuar |
| 6. | "Malvina Visoka" pf | 30.624.382,4 lekë, skualifikuar |
| 7. | "Atlantik 3" SHPK | 35.375.585 lekë, skualifikuar |
| 8. | "Pastrime Silvio" SHPK | 35.976.880,8 lekës skualifikuar |

II.4. Në datën 07.04.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues "Malvina Visoka" pf mbi arsyet e skualifikimit me arsyetimin:

*Skedat teknike të paraqitura për produktet nr.6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 nuk janë të hartuara nga prodhuesi i produkteve.*

II.5. Në datën 13.04.2023 autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën objekt shqyrtimi.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 19.04.2023, operatori ekonomik "Malvina Visoka" pf ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij, nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.7. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 831/2 datë 19.04.2023, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "Malvina Visoka" pf për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Me shkresën nr.11460/4prot., datë 24.04.2023, protokolluar me tonën nr.831/4prot., datë 27.04.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, duke dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të

autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "Malvina Visoka" pf dhe ka vendosur mospranimin të ankesës.

II.9. Me shkresën protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr. 831/3prot.datë 24.04.2023, operatori ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK ka paraqitur formular të paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik.

II.10. Me shkresën protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr. 831/5prot.datë 02.05.2023, operatori ekonomik "Malvina Visoka" pf, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik shkresën me objekt "Kundërshtim i Vendimit të Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

II.11. Në datën 07.04.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues "Pastrime Silvio" ShPK mbi arsyet e skualifikimit me arsyetimin:

*Produktet nr.23 dhe 24 nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në DST.*

II.12. Në datën 19.04.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3036 dhe me nr. 843/2023 protokolli, e operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij, nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.13. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 843/2 datë 20.04.2023, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "Pastrime Silvio" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.14. Me shkresën nr.1514/4prot., datë 24.04.2023, protokolluar me tonën nr.843/3 prot., datë 27.04.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, duke dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "Pastrime Silvio" SHPK dhe ka vendosur mospranimin të ankesës.

II.15. Në datën 07.04.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues "W.Center" ShPK mbi arsyet e skualifikimit me arsyetimin:

*Skedat teknike për produktet 16 dhe 26 nuk janë paraqitur në SPE. 2. Skedat teknike të paraqitura për produktet nr.2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 21, 22 nuk kanë të pasqyruara kërkesat teknike të kërkuara në DST. 3. Produktet e ofruara me nr.17, 18, 19, 20 nuk plotësojnë Standardin Teknik të kërkuar SSH EN 13432:2005 të kërkuar në DST për qese plastike të biodegradueshme.*

II.16. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 19.04.2023, operatori ekonomik "W. Center" SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të tij, nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.17. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 844/2 datë 20.04.2023, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "W. Center" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.18. Me shkresën nr.1515/4prot., datë 24.04.2023, protokolluar me tonën nr.844/3 prot., datë 27.04.2023, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, duke dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "W.Center" SHPK dhe ka vendosur mospranimin të ankesës.

II.19. Me shkresën protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nr. 844/3prot.datë 24.04.2023, operatori ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK ka paraqitur formular të paraqitjes së argumenteve nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik.

II.20. Komisioni i Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, vendosi në zbatim të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative si dhe nenit 24 e vijues të LPP-së me shkresën nr. 831/6prot datë 15.05.2023 me objekt "Kërkesë për informacion", ti drejtohet **Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit** në të cilën kërkoi konkretisht citojmë: *"[...]Aktualisht Komisioni është duke shqyrtuar një ankesë. Në ankesën objekt ankimi konstatojmë se nga operatori ekonomik në përmbushje të kritereve kualifikuese, është paraqitur produkt/artikull i certifikuar me ISO 14001, ISO 14021, ISO 45001 ndërsa në dokumentet e tenderit të procedurës objekt prokurimi është kërkuar produkt/artikull e konkretisht art. Qese mbeturinash të biodegradueshme dhe të prodhuara sipas standardit shqiptar SSH EN 13432:2005. Lidhur me këtë fakt, Komisioni kërkon nga ana juaj si institucion kompetent, një informacion nëse standardi i certifikimit ISO 14021 është i barasvlershëm me standardin e certifikimit SSH EN 13432:2005.[...]"*

II.21. Me shkresën nr. 272/1prot. datë 17.05.2023 protokolluar me tonën nr. 831/8prot. datë 22.05.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit na informon konkretisht citojmë: *"[...] Të dy standardet e përmendur nuk janë standarde që përdoren në procedurat e akreditimit. Për sa i takon informacionit mbi barazvlefshmërinë midis dy standardeve, mendojmë se ju duhet ti drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit e cila është organizimi kombëtar i standardeve në Shqipëri. Për sa i takon certifikimit sipas këtyre dy standardeve ju informojmë që në kuptim të DPA: Standardi ISO 14021:2016 Etiketat dhe deklaratat mjedisore –Pretendimet mjedisore të vetëdeklaruara (etiketimi mjedisor i tipit II) specifikohen kërkesat për pretendimet mjedisore të vetëdeklaruara nga kompania për produktet e saj. Certifikimi sipas këtij stadardi demostron konformitetin e vetë-deklarimeve mbi pretendimin mjedisor përkatës me kërkesat e standardit ISO 14021. Standardi S SHEN 13432:2005 "Ambalazhimi –Kërkesat për ambalazhimin nëpërmjet kompostimit dhe biodegradimit –Skema e provave kriteret e vlerësimit për pranimin përfundimtar të ambalazhimit specifikon kërkesat dhe procedurat për të përcaktuar kompostueshmërinë dhe përpunueshmërinë anaerobe të paketimit të materialeve të paketimit duke adresuar katër karakteristika: 1) biodegradueshmërinë; 2) shpërbërja gjatë trajtimit biologjik; 3) efekt në procesin e trajtimit biologjik; 4) efekt në cilësinë e kompostit që rezulton . Certifikimi sipas këtij standardi demostron konformitetin e produktit me kërkesat S SH EN 13432:2005. [...]"*

II.22. Gjithashtu me shkresën Publik me shkresën nr. 831/9prot datë 23.03.2023 me objekt "Kërkesë për informacion", i'u drejtua **Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit** në të cilën kërkoi konkretisht citojmë: *"[...]Aktualisht Komisioni është duke shqyrtuar një ankesë. Në ankesën objekt ankimi konstatojmë se nga operatori ekonomik në përmbushje të kritereve kualifikuese, është paraqitur produkt/artikull i certifikuar me ISO 14001, ISO 14021, ISO 45001 ndërsa në dokumentet e tenderit të procedurës objekt prokurimi është kërkuar produkt/artikull e konkretisht art. Qese mbeturinash të biodegradueshme dhe të prodhuara sipas standardit shqiptar SSH EN 13432:2005. Lidhur me këtë fakt, Komisioni kërkon nga ana juaj si institucion kompetent, një informacion nëse standardi i certifikimit ISO 14021 është i barasvlershëm me standardin e certifikimit SSH EN 13432:2005.[...]"*

II.23. Me shkresën nr145/1prot. datë 29.05.2023 protokolluar me tonën nr. 831/10prot. datë 31.05.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit na informon konkretisht citojmë: *"[...]Bazuar ne shkresën tuaj me nr.83 1/9 Prot, date 23.05.2023 "Kërkesë për informacion" protokolluar me tonen me nr. 145, date 25.05.2023, ju informojme se: "[...]1. Standardi ISO 14021 "Etiketat mjedisore dhe Deklaratat - Vetëdeklarimet mbi Pretendimet Mjedisore (Tipi II Etiketimi mjedisor) specifikon kerkesat per pretendimet ne vetedeklarimet mjedisore, duke perfshire deklaratat, simbolet dhe grafikat, ne lidhje me produktet. Ai pershkruan me tej termat e zgjedhur qe perdoren në pretendimet mjedisore jep mendrat/specifikimet per perdorimin e tyre. Ky Standard Ndërkombëtar pershkruan gjithashtu, nje metodologji te pergjithshme vlerësimi dhe verifikimi per pretendimet e vetëdeklaruara mjedisore dhe metodat specifike te vleresimit he verifikimit per secilin nga vetëdeklarimet e trajtuara ne kete Standard.*

*2. Standardi SSH EN 13432:2005 "Paketimi - Kerkesat për paketim te riciklueshëm pêrmes dekompozimit dhe biodegradimit - Skema e testimit de kriteret e vlerësimit per pranimin*

*perfundimtar te paketimit" specifikon kerkesat dhe procedurat per percaktimin e trajtimit te dekompozimit (anaerobe) te paketimit dhe materialeve te paketimit, duke trajtuar katër karakteristikat e mëposhtëme:1. Biodegradueshmërine,2. shpërbërjen gate trajtimit biologjik, 3. efekti ne procesin e trajtimit biologjik, 4. efekt ne cilësinë e kompostit që rezulton[...]"*

II.24. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 831/7prot datë 15.05.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i bën me dije palëve se për shkaqe të nevojshme për verifikim në përputhje me pikën 5 të nenit 115 të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" dalja e vendimit përfundimtar nuk do të jetë brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

## III

Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Malvina Visoka" pf mbi skualifikimin e tij ekonomike arsyen se "*Skedat teknike të paraqitura për produktet nr.6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 nuk janë të hartuara nga prodhuesi i produkteve"*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 *"Kriteret e veçanta të kualifikimit"*, pika 2.3.2 *"Kapaciteti teknik"*, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri*:*

***2.3.2*** *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për produktet objekt prokurimi të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it ose distributori/ët zyrtarë. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

III.1.2. Në shtojcën 5, *"Formulari i Specifikimeve Teknike"*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara,

duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

**Skicimet, parametrat teknik etj:**

| | |
|---|---|
| 1 | **Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete.**<br>Përbërja kimike: acid fosforik (10-20%) (CAS-Nr: 7664-38-2); isotridecylalkohol-ethoxylaten (<5%) (CAS-Nr: 9043-30-5), butoxy-ethanol (1-5%) (CAS-Nr: 111-76-2) ose ekuivalentet e tyre.<br>**Të dhëna teknike:**<br>Densiteti: 2 ± 0.3 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 1-1.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Përmbajtja e lëndëve tensioaktive: jo më pak se 8%.<br>Paketimi: në bidon plastik 0.5 deri 1 litra me mekanizem sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |
| 2 | **Fshesa merimangash me bisht të gjatë.** Koka te jete ne forme bohçe me fije plastike polietilen ose ekuivalent me diameter te jashtem 30-40cm. Gjatesia e fijeve 80-100 mm. Filetimi konik ose cilindrik me materiali polipropilen ose ekuivalent. Te kete bisht teleskopik me 2 ose 3 hapje dhe me gjatesi 200-250 cm. Materiali i bishtit metal i plastifikuar ose duralumin. Fileto konike ose cilindrike prej materiali polipropilen ose ekuivalentin e tij dhe te perputhen filetot e bishtit me ato te kokes plastike ne forme bohçe. |
| 3 | **Fshesa pastrimi me fije te gjata pa bisht.** Me fije te dendura dhe te buta. Me fileto per montimin e bishtit, material PVC. Bazamenti per mbajtjen e fijeve te pastrimit te jete i gjere 3-5 cm dhe me gjatesi 25 -30 cm. Materiali i fijes plastik PVC ose ekuivalent. Gjatesia e fijes 10-12 cm me dendesi jo me pak se 3500 fije. Filetot e fsheses te perputhen me ato te bishtit te ofertuar. |
| 4 | **Bishta te gjate per fshesa dhe shtupa**. Bishti te sherbeje per perdorim profesional dhe materiali i bishtit te jete perbere prej duaralumini ose metali te plastifikuar/me lyerje antikorrozive, ne forme tubi me diameter 24-26 mm dhe spesor 1-1.5 mm. Fileto e bishtit te jene konike ose cilindrike dhe te perputhen me filetimin e shtupes dhe te fsheses. Gjatesia e bishtit te jete 130-140 cm. Filetot e bishtit te perputhen me ato te fsheses te ofertuar. |

| | |
|---|---|
| 5 | **Fshese pastrimi territori me melakuq te dendur**. Duhet te jete profesionale me fije te dendura dhe me bisht druri ose metali/duralumini me gjatesi 100 -120cm dhe diameter 22-25mm. Gjatesi totale me gjithe fshese 140-160 cm. Bishti të jetë i kapur me fshesën, ne menyre te fabrikuar. Gjatësia e fijeve të fshesës 40-50cm, gjeresia e hapjes se fijeve ne fund te fsheses te jete 35-45 cm me trashësi 5-8 cm. |
| 6 | **Furçe pastrimi per WC me mbajtese.** Duhet te jete profesionale me fibra sintetike ne forme bohçe me diameter te jashtem 6-10 cm, me bisht te gjate 25-35 cm dhe e kompletuar me mbajtesen e furçes. Furça te jete me kapak te inkorporuar qe te perputhet plotesisht me mbajtesen e furçes. Mbajtesja e furçes te jete e perbere me material Polipropilen ose ekuivalent dhe te perputhet plotesisht me furçen dhe kapakun e saj. |
| 7 | **Kaci per mbledhjen e mbeturinave.** Kacia duhet te jete per perdorim profesional me depozite mbeturinash te inkorporuar me volum 2-3litra. Duhet te jete material polipropilen ose ekuivalent me bisht metalik te plastifikuar ose duralumini 80-100 cm te gjate. Tehu i kacise te jete me gjeresi 25-30 cm. |
| 8 | **Kosha plastik per mbeturina i vogel**. Koshi i mbeturinave per perdorim te brendshem duhet te jete me volum 8-10 litra, me thellesi 25 ± 5cm, gjeresi 25 ± 5cm x 18 ± 5cm (pa perfshire kapakun). Materiali te jete Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 9 | **Kosha plastik per mbeturina i mesëm**. Koshi i mbeturinave per perdorim te brendshem duhet te jete me volum 14-16 litra, me thellesi 35 ± 5cm, gjeresi 30 ± 5cm x 25 ± 5cm cm (pa perfshire kapakun). Materiali te jete Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 10 | **Kosha plastik per mbeturina i madh**. Koshi i mbeturinave per perdorim te jashtem duhet te jete me kapacitet 60-70 Litra, me thellesi 60 ± 5cm gjeresi 50 ± 5cm x 40 ± 5cm cm (pa perfshire kapakun), materiali Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 11 | **Kosh plastik për mbeturina me rrota**. Koshi të ketë të montuara jo më pak se dy rrota për spostimin e tij nga një vend ne tjetrin. Duhet të jetë me kapacitet 100-120 Litra, me dimensione 50 ± 10cm x 60 ± 10cm x 100 ± 10cm, material Polipropilen (PP), kapaku të ketë dorezë për kapje dhe të lëvizë me anë të menteshave të kapura në trupin e koshit për hapje dhe mbyllje. Të jetë në përputhje me standartin shqiptar SSH EN 840-1:2012 ose ekuivalentin e tij. |

| | |
|---|---|
| 12 | **Kova larje me shtrydhese komplet**. Kova per pastrim/larje me mekanizem per shtrydhese ku mekanizmi i shtrydhjes te jete i çmontueshem lehtesisht. Kova duhet te jete me volum 16 -18 litra ku ne trupin e koves te jene te stampuara ndarja ne litra nga jo me pak se nje liter per ndarje. Te jete e perbere nga materiali Polipropilen ose ekuivalenti i tij, te kete doreze plastike per mbajtje dhe buze per derdhjen e ujit. |
| 13 | **Mekanizem shtrydhes (rezervë) per kova larje.** Te jete material i forte polipropilen ose ekuivalenti i tij dhe t`i pershtatet kovave të larjes objekt prokurimi (produkti me nr.13) duke u montuar dhe çmontuar lehtesisht. |
| 14 | **Pecete pastrimi mikrofiber**. Peceta te jete e pershtatshme per pastrimin e siperfaqeve te ndryshme. Me permasa 40 ± 10 cm x 40 ± 10 cm, me siperfaqe te pergjithshme jo me pak se 1500 $cm^2$, materiali te jete i perbere nga jo me pak se 80 ± 10 % poliester dhe nga 20 ± 5 % poliamyde, me peshe specifike jo me pak se 200 $g/m^2$. Paketimi ne plasmas ose karton ne jo me shume se dy cope per paketim. |
| 15 | **Leter higjenike per WC**. Leter higjenike per perdorim profesional me paketim mini jumbo. Te jete e perbere nga celuloze e paster me minimumi 2 shtresa dhe peshe specifike jo me pak se 15$g/m^2$. Gjatesia e letres se rulonit 140-160 metra. Gjeresia e letres 9-10 cm. Diametri i jashtëm i rulonit të jetë 60-75 cm. Diametri i brendshëm i rulonit të jetë 19-20 cm. Paketimi ne pako me 6-12 rulona me plasmas ose karton. |
| 16 | **Mekanizem mbajtes dhe shperndares per letrat higjenike të WC (dispencer).** Te jete i pershatshem per perdorim profesional ne tualete. Lloji i letres higjenike te perdorur do te jete paketim minijumbo me kerkesat teknike te paraqitura per produktin ne piken 15 te kesaj tabele. Te jete me material polipropilen ose ekuivalenti i tij, Te kete dritare per te mundesuar monitorimin e konsumit te letres higjenike. Dispenceri te hapet dhe te mbyllet me nje mekanizem (çeles) te veçante per te parandaluar shperdorimin e letres higjenike. |
| 17 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 35 ± 5cm x 35± 5cm, 30-40 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij. |
| 18 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 50 ± 5cm x 60± 5cm, 40-50 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij. |
| 19 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 60 ± 10cm x 80 ± 10cm, 70-80 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij. |

| | |
|---|---|
| 20 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 80 ± 10cm x 100± 10cm, volumi 100-120 litra, trashesia 30-40 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij. |
| 21 | **Shtupa per larje dyshemeje.** Bazamenti i shtupës per montimin e bishtit te jete prej polipropileni ese ekuivalenti i tij me fileto cilindrike ose konike, materiali i shtupes te jete i perbere nga jo me pak se 80 ± 10 % poliester dhe nga 20 ± 5 % poliamyde, me peshe specifike jo me pak se 200 g/m², gjatesia e fijes 35 ± 5 cm. Filetot e shtupës te perputhen me ato te bishtit te ofertuar. Pesha e produktit 200-300gr. |
| 22 | **Sfungjer per larjen e aksesoreve hidrosanitarë.** Permasat Gjatesia 150 ± 10 mm x Gjeresia 80 ± 10mm x Trashesia 35 ± 5 mm, me material sfungjerik sintetik ku materiali i ashpersuar te jete me trashesi 5-7 mm. Material te jete poroz që nuk lejon zhvillimin e baktereve, dhe të ketë jetëgjatësi. Paketimi ne qese plastike ose karton me 2-6 cope dhe sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. |
| 23 | **Detergjent i përqendruar për larjen e dyshemese.**<br>Perberja kimike: Tensioaktivë kationikë ≤ 5%, tensioaktivë jo-jonikë ≤ 5%. Të ketë në përbërje të paktën një lëndë dezinfektuese nga komponime të amoniumit kuaternar.<br>Të dhëna teknike:<br>Densiteti: 1 ± 0.1 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 7 ± 0.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Paketimi: në bidona plastik 1 deri në 5 litër sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |
| 24 | **Detergjent per larje xhamash.**<br>Perberja kimike: 2-Butoxyethanol (5-10%) (CAS-Nr: 111-76-2). Te miratuara sipas normativave te databazes se ECHA dhe direktivave te BE.<br>Te dhena teknike:<br>Densiteti: 1 ± 0.1 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 11-11.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Përmbajtja e lëndëve tensioaktive: <8%<br>Paketimi në bidon plastik 0.5 deri ne 1 litër me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |
| 25 | **Letra per fshirje e duarve e palosur z/v-Fold.** Leter higjenike duarsh per perdorim profesional me paketim z/v fold. Te jete e perbere nga celuloze e paster me minimumi 2 shtresa dhe peshe specifike jo me pak se 15g/m². Pakoja te permbaje jo me pak se 200 fije. Gjeresia e paketimit 10.5 ± 0.5 cm. Gjatesia e paketimit 21.5 ± 0.5 cm. Paketimi ne pako me jo me pak se 200 fije me pasmas ose karton. Ngjyre e bardhe. |

| | |
|---|---|
| 26 | **Mekanizem mbajtes dhe shperndares per letrat higjenike te duarve (dispencer)**. Te jete i pershatshem per perdorim profesional ne tualete. Lloji i letres higjenike te perdorur do te jete me paketim z/v Fold ne perputhje me kerkesat teknike te paraqitura per produktin ne piken 25 te kesaj tabele me kapacitet mbajtes jo me pak se 400 fije letre higjenike z/v Fold. Mekanizmi te jete me material polipropilen ose ekuivalenti i tij. Te kete dritare per te mundesuar monitorimin e konsumit te letres higjenike te duarve. Dispenceri te hapet dhe te mbyllet me nje mekanizem (çeles) te veçante per te parandaluar shperdorimin e letres higjenike. |

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontratë) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit.

Furnizimi do të bëhet me mjetet teknike të furnizuesit në çdo objekt shkollor sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor në sasi, lloj dhe kohë brenda afatit të përcaktuar në çdo minikontratë të lidhur nga data e nënshkrimit. Lloji dhe sasia e mallrave objekt prokurimi që do të shpërndahen do të përcaktohen qartë nga Autoritetit Kontraktor për çdo objekt shkollor dhe parashkollor në planin e shpërndarjes i cili do të vihet në dispozicion të operatorit ekonomik fitues ditën e nënshkrimit të çdo minikontrate.

Të gjitha paketimet e mallrave objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.669 datë 28.09.2011, "Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentet", dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Ndërsa në shtojcën 6, *"Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit"*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

**Shtojca 6**

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

| Nr. | Përshkrimi i mallrave | Njësia | Sasia e pritshme |
|---|---|---|---|
| **1** | Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete | litra | **14 715** |
| **2** | Fshesa merimangash me bisht të gjatë | copë | **182** |
| **3** | Fshesa pastrimi me fije të gjata pa bisht | copë | **918** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **4** | Bishta të gjatë për fshesa dhe shtupa | copë | **1 859** |
| **5** | Fshesë pastrimi territori me melakuqi të dendur | copë | **300** |
| **6** | Furçë pastrimi për WC me mbajtëse | copë | **975** |
| **7** | Kaci për mbledhjen e mbeturinave | copë | **849** |
| **8** | Kosh plastik për mbeturina i vogël | copë | **464** |
| **9** | Kosh plastik për mbeturina i mesëm | copë | **1 387** |
| **10** | Kosh plastik për mbeturina i madh | copë | **140** |
| **11** | Kosh plastik për mbeturina me rrota | copë | **148** |
| **12** | Kovë për larje me shtrydhëse komplet | copë | **848** |
| **13** | Mekanizëm shtrydhje (rezervë) për kovat e larjes | copë | **410** |
| **14** | Pecetë pastrimi mikrofibër | copë | **11 244** |
| **15** | Letër higjenike për WC | copë | **15 368** |
| **16** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të ËC | copë | **247** |
| **17** | Qese mbeturinash 30-35 litra | copë | **167 376** |
| **18** | Qese mbeturinash 50-60 litra | copë | **164 136** |
| **19** | Qese mbeturinash 70-80 litra | copë | **71 104** |
| **20** | Qese mbeturinash 100-120 litra | copë | **28 846** |
| **21** | Shtupë për larje dyshemeje | copë | **2 822** |
| **22** | Sfungjer për larjen e aksesorëve hidrosanitarë | copë | **15 229** |
| **23** | Detergjent për larjen e dyshemesë | litra | **49 077** |
| **24** | Detergjent për larjen e xhamave | litra | **2 177** |
| **25** | Letër higjenike për fshirjen e duarve z/v-Fold | pako | **67 558** |
| **26** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të duarve z/v Fold | copë | **247** |

**Grafiku i lëvrimit të mallit** do të njoftohet nga autoriteti kontraktor krahas çdo minikontrate që do të lidhet në zbatim dhe brenda afatit të marrëveshjes kuadër.

**Afatet e lëvrimit:**

| **Nr.** | **Përshkrimi i mallrave** | **Njësia** | **Sasia** | **Destinacioni** | **Periudha e dorëzimit** |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete | litra | **14 715** | DPOP | 12 muaj |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **2** | Fshesa merimangash me bisht të gjatë | copë | **182** | DPOP | 12 muaj |
| **3** | Fshesa pastrimi me fije të gjata pa bisht | copë | **918** | DPOP | 12 muaj |
| **4** | Bishta të gjatë për fshesa dhe shtupa | copë | **1 859** | DPOP | 12 muaj |
| **5** | Fshesë pastrimi territori me melakuqi të dendur | copë | **300** | DPOP | 12 muaj |
| **6** | Furçë pastrimi për WC me mbajtëse | copë | **975** | DPOP | 12 muaj |
| **7** | Kaci për mbledhjen e mbeturinave | copë | **849** | DPOP | 12 muaj |
| **8** | Kosh plastik për mbeturina i vogël | copë | **464** | DPOP | 12 muaj |
| **9** | Kosh plastik për mbeturina i mesëm | copë | **1 387** | DPOP | 12 muaj |
| **10** | Kosh plastik për mbeturina i madh | copë | **140** | DPOP | 12 muaj |
| **11** | Kosh plastik për mbeturina me rrota | copë | **148** | DPOP | 12 muaj |
| **12** | Kovë për larje me shtrydhëse komplet | copë | **848** | DPOP | 12 muaj |
| **13** | Mekanizëm shtrydhje (rezervë) për kovat e larjes | copë | **410** | DPOP | 12 muaj |
| **14** | Pecetë pastrimi mikrofibër | copë | **11 244** | DPOP | 12 muaj |
| **15** | Letër higjenike për WC | copë | **15 368** | DPOP | 12 muaj |
| **16** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të WC | copë | **247** | DPOP | 12 muaj |
| **17** | Qese mbeturinash 30-35 litra | copë | **167 376** | DPOP | 12 muaj |
| **18** | Qese mbeturinash 50-60 litra | copë | **164 136** | DPOP | 12 muaj |
| **19** | Qese mbeturinash 70-80 litra | copë | **71 104** | DPOP | 12 muaj |
| **20** | Qese mbeturinash 100-120 litra | copë | **28 846** | DPOP | 12 muaj |
| **21** | Shtupë për larje dyshemeje | copë | **2 822** | DPOP | 12 muaj |
| **22** | Sfungjer për larjen e aksesorëve hidrosanitarë | copë | **15 229** | DPOP | 12 muaj |
| **23** | Detergjent për larjen e dyshemesë | litra | **49 077** | DPOP | 12 muaj |
| **24** | Detergjent për larjen e xhamave | litra | **2 177** | DPOP | 12 muaj |
| **25** | Letër higjenike për fshirjen e duarve z/v-Fold | pako | **67 558** | DPOP | 12 muaj |
| **26** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të duarve z/v Fold | copë | **247** | DPOP | 12 muaj |

Shpjegim i termave: **DPOP** → Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik "Malvina Visoka" pf në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

*Autorizim "Mari"shpk*

*Autorizim datë 20.03.2023 "Senyayla Plastik Sanayii.ve ticaret"*
*Skedat teknike për artikujt e konkretisht për artikujt 6,7,8,9,10,11,12,13*

III.1.4. Neni 2 "Qëllimi i ligjit" 162/2021 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se: "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik*".

Ndërkohë në neni 3 "Parime të përgjithshme" 162/2021 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se: "*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën*".

Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 *"Kërkesat për kualifikim"* të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" parashikohet shprehimisht se:

*"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie"*

III.1.5. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*"1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.*

*2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

*3. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

*b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.".*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen

e specifikimeve teknike të produkteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e specifikimeve të mallrave/shërbimeve të ofertuara prej tyre, me ato të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me specifikimet përkatëse të kërkuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.7. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, dorëzimin e dokumentit skeedave teknike, për produktet objekt-prokurimi të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it ose distributori/ët zyrtarë. Fragmentet e katalogut/ve duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues Malvina Visoka pf rezulton, se është paraqitur dokumenti autorizim i lëshuar nga kompania “Mari” ShPK e cila emëron kompaninë “Malvina Visoka” pf për tregtimin dhe reklamimin e produktet eve që importojnë e prodhojnë, gjithashtu ankimuesi ka paraqitur edhe dokumentin autorizim datë 20.03.2023 të lëshuar nga kompania “Senyayla Plastik Sanayii.ve ticaret”, ku kjo e fundit autorizon kompaninë “Mari” ShPK për të rishitur dhe për të bërë marketing lidhur me produktet e saj [...] duke listuar produktet [...]. Gjithashtu, ankimuesi ka paraqitur dhe skedat teknike, ndër të tjera edhe për artikujt 6,7,8,9,10,11,12,13.

KPP gjykon, se argumenti i skualifikimit i dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave për operatorin Malvina Visoka pf në rastin konkret është i pabazuar.
Arsyetimi i KVO-së se *Skedat teknike të paraqitura për produktet nr.6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 nuk janë të hartuara nga prodhuesi i produkteve*, nuk qëndron, pasi në vlerësimin e Komisionit dokumenti i dorëzuar nga ankimuesi, shpreh qartë se kompania “Senyayla Plastik Sanayii.ve ticaret” autorizon kompaninë “Mari” ShPK për të rishitur dhe për të bërë marketing lidhur me produktet e saj dhe kjo e fundit autorizon ankimuesin “Malvina Visoka” pf për tregtim dhe reklamim të produkteve. KPP gjykon, se në rastin konkret provohet tërësisht se ankimuesi ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në procedurën objekt-shqyrtimi, këtë e provojnë të gjitha dokumentet e dorëzuara nga ankimuesi të tilla si autorizimet dhe skedat teknike. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik Malvina Visoka pf, është në kushtet e plotësimit të kritereve kualifikuese sa i takon skedave teknike dokument në të cilin përshkruhen specifikimet teknike të artikujve të kërkuar.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” ShPK mbi skualifikimin e tij ekonomike arsyen se “*Produktet nr.23 dhe 24 nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në DST”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, pika 2.3.2 *“Kapaciteti teknik”*, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri*:*

***2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për produktet objekt prokurimi të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it ose distributori/ët zyrtarë. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

III.2.2. Në shtojcën 5, *“Formulari i Specifikimeve Teknike”*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

**Skicimet, parametrat teknik etj:**

| | |
|---|---|
| 1 | **Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete.**<br>Përbërja kimike: acid fosforik (10-20%) (CAS-Nr: 7664-38-2); isotridecylalkohol-ethoxylaten (<5%) (CAS-Nr: 9043-30-5), butoxy-ethanol (1-5%) (CAS-Nr: 111-76-2) ose ekuivalentet e tyre.<br>**Të dhëna teknike:**<br>Densiteti: 2 ± 0.3 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 1-1.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Përmbajtja e lëndëve tensioaktive: jo më pak se 8%.<br>Paketimi: në bidon plastik 0.5 deri 1 litra me mekanizem sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |
| 2 | **Fshesa merimangash me bisht të gjatë.** Koka te jete ne forme bohçe me fije plastike polietilen ose ekuivalent me diameter te jashtem 30-40cm. Gjatesia e fijeve 80-100 mm. Filetimi konik ose cilindrik me materiali polipropilen ose ekuivalent. Te kete bisht teleskopik me 2 ose 3 hapje dhe me gjatesi 200-250 cm. Materiali i bishtit metal i plastifikuar ose duralumin. Fileto konike ose cilindrike prej materiali polipropilen ose ekuivalentin e tij dhe te perputhen filetot e bishtit me ato te kokes plastike ne forme bohçe. |
| 3 | **Fshesa pastrimi me fije te gjata pa bisht.** Me fije te dendura dhe te buta. Me fileto per montimin e bishtit, material PVC. Bazamenti per mbajtjen e fijeve te pastrimit te jete i gjere 3-5 cm dhe me gjatesi 25 -30 cm. Materiali i fijes plastik PVC ose ekuivalent. Gjatesia e fijes 10-12 cm me dendesi jo me pak se 3500 fije. Filetot e fsheses te perputhen me ato te bishtit te ofertuar. |
| 4 | **Bishta te gjate per fshesa dhe shtupa**. Bishti te sherbeje per perdorim profesional dhe materiali i bishtit te jete perbere prej duaralumini ose metali te plastifikuar/me lyerje antikorrozive, ne forme tubi me diameter 24-26 mm dhe spesor 1-1.5 mm. Fileto e bishtit te jene konike ose cilindrike dhe te perputhen me filetimin e shtupes dhe te fsheses. Gjatesia e bishtit te jete 130-140 cm. Filetot e bishtit te perputhen me ato te fsheses te ofertuar. |
| 5 | **Fshese pastrimi territori me melakuq te dendur**. Duhet te jete profesionale me fije te dendura dhe me bisht druri ose metali/duralumini me gjatesi 100 -120cm dhe diameter 22-25mm. Gjatesi totale me gjithe fshese 140-160 cm. Bishti të jetë i kapur me fshesën, ne menyre te fabrikuar. Gjatësia e fijeve të fshesës 40-50cm, gjeresia e hapjes se fijeve ne fund te fsheses te jete 35-45 cm me trashësi 5-8 cm. |
| 6 | **Furçe pastrimi per WC me mbajtese.** Duhet te jete profesionale me fibra sintetike ne forme bohçe me diameter te jashtem 6-10 cm, me bisht te gjate 25-35 cm dhe e kompletuar me mbajtesen e furçes. Furça te jete me kapak te inkorporuar qe te perputhet plotesisht me mbajtesen e furçes. Mbajtesja e furçes te jete e perbere me material Polipropilen ose ekuivalent dhe te perputhet plotesisht me furçen dhe kapakun e saj. |

| | |
|---|---|
| 7 | **Kaci per mbledhjen e mbeturinave.** Kacia duhet te jete per perdorim profesional me depozite mbeturinash te inkorporuar me volum 2-3litra. Duhet te jete material polipropilen ose ekuivalent me bisht metalik te plastifikuar ose duralumini 80-100 cm te gjate. Tehu i kacise te jete me gjeresi 25-30 cm. |
| 8 | **Kosha plastik per mbeturina i vogel**. Koshi i mbeturinave per perdorim te brendshem duhet te jete me volum 8-10 litra, me thellesi 25 ± 5cm, gjeresi 25 ± 5cm x 18 ± 5cm (pa perfshire kapakun). Materiali te jete Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 9 | **Kosha plastik per mbeturina i mesëm**. Koshi i mbeturinave per perdorim te brendshem duhet te jete me volum 14-16 litra, me thellesi 35 ± 5cm, gjeresi 30 ± 5cm x 25 ± 5cm cm (pa perfshire kapakun). Materiali te jete Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 10 | **Kosha plastik per mbeturina i madh**. Koshi i mbeturinave per perdorim te jashtem duhet te jete me kapacitet 60-70 Litra, me thellesi 60 ± 5cm gjeresi 50 ± 5cm x 40 ± 5cm cm (pa perfshire kapakun), materiali Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 11 | **Kosh plastik për mbeturina me rrota**. Koshi të ketë të montuara jo më pak se dy rrota për spostimin e tij nga një vend ne tjetrin. Duhet të jetë me kapacitet 100-120 Litra, me dimensione 50 ± 10cm x 60 ± 10cm x 100 ± 10cm, material Polipropilen (PP), kapaku të ketë dorezë për kapje dhe të lëvizë me anë të menteshave të kapura në trupin e koshit për hapje dhe mbyllje. Të jetë në përputhje me standartin shqiptar SSH EN 840-1:2012 ose ekuivalentin e tij. |
| 12 | **Kova larje me shtrydhese komplet**. Kova per pastrim/larje me mekanizem per shtrydhese ku mekanizmi i shtrydhjes te jete i çmontueshem lehtesisht. Kova duhet te jete me volum 16 -18 litra ku ne trupin e koves te jene te stampuara ndarja ne litra nga jo me pak se nje liter per ndarje. Te jete e perbere nga materiali Polipropilen ose ekuivalenti i tij, te kete doreze plastike per mbajtje dhe buze per derdhjen e ujit. |
| 13 | **Mekanizem shtrydhes (rezervë) per kova larje.** Te jete material i forte polipropilen ose ekuivalenti i tij dhe t`i pershtatet kovave të larjes objekt prokurimi (produkti me nr.13) duke u montuar dhe çmontuar lehtesisht. |

| | |
|---|---|
| 14 | **Pecete pastrimi mikrofiber**. Peceta te jete e pershtatshme per pastrimin e siperfaqeve te ndryshme. Me permasa 40 ± 10 cm x 40 ± 10 cm, me siperfaqe te pergjithshme jo me pak se 1500 cm², materiali te jete i perbere nga jo me pak se 80 ± 10 % poliester dhe nga 20 ± 5 % poliamyde, me peshe specifike jo me pak se 200 g/m². Paketimi ne plasmas ose karton ne jo me shume se dy cope per paketim. |
| 15 | **Leter higjenike per WC**. Leter higjenike per perdorim profesional me paketim mini jumbo. Te jete e perbere nga celuloze e paster me minimumi 2 shtresa dhe peshe specifike jo me pak se 15g/m². Gjatesia e letres se rulonit 140-160 metra. Gjeresia e letres 9-10 cm. Diametri i jashtëm i rulonit të jetë 60-75 cm. Diametri i brendshëm i rulonit të jetë 19-20 cm. Paketimi ne pako me 6-12 rulona me plasmas ose karton. |
| 16 | **Mekanizem mbajtes dhe shperndares per letrat higjenike të WC (dispencer).** Te jete i pershatshem per perdorim profesional ne tualete. Lloji i letres higjenike te perdorur do te jete paketim minijumbo me kerkesat teknike te paraqitura per produktin ne piken 15 te kesaj tabele. Te jete me material polipropilen ose ekuivalenti i tij, Te kete dritare per te mundesuar monitorimin e konsumit te letres higjenike. Dispenceri te hapet dhe te mbyllet me nje mekanizem (çeles) te veçante per te parandaluar shperdorimin e letres higjenike. |
| 17 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 35 ± 5cm x 35± 5cm, 30-40 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij. |
| 18 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 50 ± 5cm x 60± 5cm, 40-50 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij. |
| 19 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 60 ± 10cm x 80 ± 10cm, 70-80 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij. |
| 20 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 80 ± 10cm x 100± 10cm, volumi 100-120 litra, trashesia 30-40 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij. |
| 21 | **Shtupa per larje dyshemeje.** Bazamenti i shtupës per montimin e bishtit te jete prej polipropileni ese ekuivalenti i tij me fileto cilindrike ose konike, materiali i shtupes te jete i perbere nga jo me pak se 80 ± 10 % poliester dhe nga 20 ± 5 % poliamyde, me peshe specifike jo me pak se 200 g/m², gjatesia e fijes 35 ± 5 cm. Filetot e shtupës te perputhen me ato te bishtit te ofertuar. Pesha e produktit 200-300gr. |

| | |
|---|---|
| 22 | **Sfungjer per larjen e aksesoreve hidrosanitarë.** Permasat Gjatesia 150 ± 10 mm x Gjeresia 80 ± 10mm x Trashesia 35 ± 5 mm, me material sfungjerik sintetik ku materiali i ashpersuar te jete me trashesi 5-7 mm. Material te jete poroz që nuk lejon zhvillimin e baktereve, dhe të ketë jetëgjatësi. Paketimi ne qese plastike ose karton me 2-6 cope dhe sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. |
| 23 | **Detergjent i përqendruar për larjen e dyshemese.**<br>Perberja kimike: Tensioaktivë kationikë ≤ 5%, tensioaktivë jo-jonikë ≤ 5%. Të ketë në përbërje të paktën një lëndë dezinfektuese nga komponime të amoniumit kuaternar.<br>Të dhëna teknike:<br>Densiteti: 1 ± 0.1 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 7 ± 0.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Paketimi: në bidona plastik 1 deri në 5 litër sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |
| 24 | **Detergjent per larje xhamash.**<br>Perberja kimike: 2-Butoxyethanol (5-10%) (CAS-Nr: 111-76-2). Te miratuara sipas normativave te databazes se ECHA dhe direktivave te BE.<br>Te dhena teknike:<br>Densiteti: 1 ± 0.1 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 11-11.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Përmbajtja e lëndëve tensioaktive: <8%<br>Paketimi në bidon plastik 0.5 deri ne 1 litër me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |
| 25 | **Letra per fshirje e duarve e palosur z/v-Fold.** Leter higjenike duarsh per perdorim profesional me paketim z/v fold. Te jete e perbere nga celuloze e paster me minimumi 2 shtresa dhe peshe specifike jo me pak se 15g/m². Pakoja te permbaje jo me pak se 200 fije. Gjeresia e paketimit 10.5 ± 0.5 cm. Gjatesia e paketimit 21.5 ± 0.5 cm. Paketimi ne pako me jo me pak se 200 fije me pasmas ose karton. Ngjyre e bardhe. |
| 26 | **Mekanizem mbajtes dhe shperndares per letrat higjenike te duarve (dispencer)**. Te jete i pershatshem per perdorim profesional ne tualete. Lloji i letres higjenike te perdorur do te jete me paketim z/v Fold ne perputhje me kerkesat teknike te paraqitura per produktin ne piken 25 te kesaj tabele me kapacitet mbajtes jo me pak se 400 fije letre higjenike z/v Fold. Mekanizmi te jete me material polipropilen ose ekuivalenti i tij. Te kete dritare per te mundesuar monitorimin e konsumit te letres higjenike te duarve. Dispenceri te hapet dhe te mbyllet me nje mekanizem (çeles) te veçante per te parandaluar shperdorimin e letres higjenike. |

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontratë) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit.

Furnizimi do të bëhet me mjetet teknike të furnizuesit në çdo objekt shkollor sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor në sasi, lloj dhe kohë brenda afatit të përcaktuar në çdo minikontratë të lidhur nga data e nëshkrimit. Lloji dhe sasia e mallrave objekt prokurimi që do të shpërndahen do të përcaktohen qartë nga Autoritetit Kontraktor për çdo objekt shkollor dhe parashkollor në planin e shpërndarjes i cili do të vihet në dispozicion të operatorit ekonomik fitues ditën e nënshkrimit të çdo minikontrate.

Të gjitha paketimet e mallrave objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.669 datë 28.09.2011, "Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentët", dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Ndërsa në shtojcën 6, *"Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit"*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

**Shtojca 6**

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

| **Nr.** | **Përshkrimi i mallrave** | **Njësia** | **Sasia e pritshme** |
|---|---|---|---|
| **1** | Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete | litra | **14 715** |
| **2** | Fshesa merimangash me bisht të gjatë | copë | **182** |
| **3** | Fshesa pastrimi me fije të gjata pa bisht | copë | **918** |
| **4** | Bishta të gjatë për fshesa dhe shtupa | copë | **1 859** |
| **5** | Fshesë pastrimi territori me melakuqi të dendur | copë | **300** |
| **6** | Furçë pastrimi për WC me mbajtëse | copë | **975** |
| **7** | Kaci për mbledhjen e mbeturinave | copë | **849** |
| **8** | Kosh plastik për mbeturina i vogël | copë | **464** |
| **9** | Kosh plastik për mbeturina i mesëm | copë | **1 387** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **10** | Kosh plastik për mbeturina i madh | copë | **140** |
| **11** | Kosh plastik për mbeturina me rrota | copë | **148** |
| **12** | Kovë për larje me shtrydhëse komplet | copë | **848** |
| **13** | Mekanizëm shtrydhje (rezervë) për kovat e larjes | copë | **410** |
| **14** | Pecetë pastrimi mikrofibër | copë | **11 244** |
| **15** | Letër higjenike për WC | copë | **15 368** |
| **16** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të ËC | copë | **247** |
| **17** | Qese mbeturinash 30-35 litra | copë | **167 376** |
| **18** | Qese mbeturinash 50-60 litra | copë | **164 136** |
| **19** | Qese mbeturinash 70-80 litra | copë | **71 104** |
| **20** | Qese mbeturinash 100-120 litra | copë | **28 846** |
| **21** | Shtupë për larje dyshemeje | copë | **2 822** |
| **22** | Sfungjer për larjen e aksesorëve hidrosanitarë | copë | **15 229** |
| **23** | Detergjent për larjen e dyshemesë | litra | **49 077** |
| **24** | Detergjent për larjen e xhamave | litra | **2 177** |
| **25** | Letër higjenike për fshirjen e duarve z/v-Fold | pako | **67 558** |
| **26** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të duarve z/v Fold | copë | **247** |

**Grafiku i lëvrimit të mallit** do të njoftohet nga autoriteti kontraktor krahas çdo minikontrate që do të lidhet në zbatim dhe brenda afatit të marrëveshjes kuadër.

**Afatet e lëvrimit:**

| Nr. | Përshkrimi i mallrave | Njësia | Sasia | Destinacioni | Periudha e dorëzimit |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete | litra | **14 715** | DPOP | 12 muaj |
| **2** | Fshesa merimangash me bisht të gjatë | copë | **182** | DPOP | 12 muaj |
| **3** | Fshesa pastrimi me fije të gjata pa bisht | copë | **918** | DPOP | 12 muaj |
| **4** | Bishta të gjatë për fshesa dhe shtupa | copë | **1 859** | DPOP | 12 muaj |
| **5** | Fshesë pastrimi territori me melakuqi të dendur | copë | **300** | DPOP | 12 muaj |
| **6** | Furçë pastrimi për WC me mbajtëse | copë | **975** | DPOP | 12 muaj |
| **7** | Kaci për mbledhjen e mbeturinave | copë | **849** | DPOP | 12 muaj |
| **8** | Kosh plastik për mbeturina i vogël | copë | **464** | DPOP | 12 muaj |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **9** | Kosh plastik për mbeturina i mesëm | copë | **1 387** | DPOP | 12 muaj |
| **10** | Kosh plastik për mbeturina i madh | copë | **140** | DPOP | 12 muaj |
| **11** | Kosh plastik për mbeturina me rrota | copë | **148** | DPOP | 12 muaj |
| **12** | Kovë për larje me shtrydhëse komplet | copë | **848** | DPOP | 12 muaj |
| **13** | Mekanizëm shtrydhje (rezervë) për kovat e larjes | copë | **410** | DPOP | 12 muaj |
| **14** | Pecetë pastrimi mikrofibër | copë | **11 244** | DPOP | 12 muaj |
| **15** | Letër higjenike për WC | copë | **15 368** | DPOP | 12 muaj |
| **16** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të WC | copë | **247** | DPOP | 12 muaj |
| **17** | Qese mbeturinash 30-35 litra | copë | **167 376** | DPOP | 12 muaj |
| **18** | Qese mbeturinash 50-60 litra | copë | **164 136** | DPOP | 12 muaj |
| **19** | Qese mbeturinash 70-80 litra | copë | **71 104** | DPOP | 12 muaj |
| **20** | Qese mbeturinash 100-120 litra | copë | **28 846** | DPOP | 12 muaj |
| **21** | Shtupë për larje dyshemeje | copë | **2 822** | DPOP | 12 muaj |
| **22** | Sfungjer për larjen e aksesorëve hidrosanitarë | copë | **15 229** | DPOP | 12 muaj |
| **23** | Detergjent për larjen e dyshemesë | litra | **49 077** | DPOP | 12 muaj |
| **24** | Detergjent për larjen e xhamave | litra | **2 177** | DPOP | 12 muaj |
| **25** | Letër higjenike për fshirjen e duarve z/v-Fold | pako | **67 558** | DPOP | 12 muaj |
| **26** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të duarve z/v Fold | copë | **247** | DPOP | 12 muaj |

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik "Pastrime Silvio" ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

*Dokumentintin (Linker) Losoxinat VP 1445; fleta e të dhënave të sigurisë*
*Dokumentin EG SICHERHEITSDATENBLATT (Xyloquat-Desinfektionsreiniger (Baua-Rg-Nr.N-27653)*

III.2.4. Në nenin 2 "*Qëllimi*" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se: *"Qëllim i këtij ligji është:*
*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."*

Ndërkohe në nenin 3 "*Parime të përgjithshme*" të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, parashikohet shprehimisht se:

*"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*"

III.2.5. Referuar nenit 36 *"Specifikimet teknike"* të Ligjit nr.162/2020 "*Për prokurimin publik*" parashikon: "*1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.*

*Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose*

*specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.*

III.2.6. Neni 77 "*Kërkesat për kualifikim*", pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", parashikohet shprehimisht se: *"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie"*

III.2.7. Në nenin 40 pika 6 "*Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave*" të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*
*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
***b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose***
***c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.***

III.2.8. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të

kontratës objekt-prokurimi. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.2.9. Komisioni Prokurimit Publik referuar arsyes së skualifikimit të cituar në raport audit nga komisioni i vlerësimit të ofertave, si dhe pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi vëren, se ankimuesi ka paraqitur në përputhje me kriterin e kërkuar "*art. 23 detergjent për larjen e dyshemesë (xyloquat) me skedën teknike dhe art.24 detergjent për larjëen e xhamave (losoxinat)"* skedat teknike, të cilat referuar arsyes së skualifikimit ka qenë objekt-shqyrtimi nga KVO e autoritetit kontraktor. Por KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues "Pastrime Silvio" SHPK dhe skualifikimin e tij, nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke skualifikuar operatorin ekonomik ankimues "Pastrime Silvio" SHPK në mënyrë abuzive dhe të paargumentuar, pa përcaktuar se cilën nga specifikimet teknike të përcaktuara në DST e procedurës të përcaktuara nga autoriteti kontrtaktor nuk përmbush artikujt/detergjentët (art. 23; art.24) të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues "Pastrime Silvio" SHPK. Gjykojmë, se ashtu sikurse është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me përmbushjen e kriterit konkret, si dhe të specifikimeve teknike të kërkuara, edhe autoriteti kontraktor (komisioni vlerësimit të ofertave) ka barrën e provës të vërtetojë dhe argumentojë, se cilin nga specifikimet teknike nuk përmbushin artikujt (referuar skedave teknike) të dorëzuara duke mirëargumentuar edhe mosplotësimin e tyre. Bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", barra e provës në rastin konkret për vërtetueshmërinë e pretendimit (arsyes së skualifikimit), i takonte komisionit të vlerësimit të ofertave të identifikonte në mënyrë të saktë dhe të qartë, se cilin nga specifikimet teknike nuk përmbushte artikujt/detergjentët (art. 23; art.24) të dorëzuar duke dhënë argumentet mbi këtë fakt, i cili në rastin konkret ka dështuar t'i evidentojë dhe t'i argumentojë. Nuk mund të lejohet skualifikimi i një operatori ekonomik, në rast se ai ka plotësuar kriterin duke dorëzuar skedat teknike të kërkuara, për sa kohë që vetë autoriteti kontraktor, i cili ka vlerësuar ofertën e tij, nuk ka evidentuar në mënyrë të qartë se cilën nga specifikimet teknike të përcaktuara në DST e procedurës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor nuk përmbush artikujt e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues. Në këtë kuadër KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit, e pasqyruar në raport-audit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave se: *"Produktet nr.23 dhe 24 nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara në DST*, është abuzive dhe e paargumentuar. KPP gjykon, se vetë autoriteti kontraktor ka kërkuar, që *operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për produktet objekt prokurimi të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it ose distributori/ët zyrtarë. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.* Në rastin konkret ankimuesi ka provuar se sipas tij përmbush kriterin e përcaktuar më sipër me dorëzimin e skedave teknike për art. 23 dhe art.24 përkatësisht art. 23 detergjent për larjen

e dyshemesë (***xyloquat)*** me skedën teknike dhe art.24 detergjent për larjen e xhamave ***(losoxinat)****”*, dhe i mbetej KVO-së së autoritetit kontraktor që në mbështetje të arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Pastrim Silvio” SHPK të argumentonte, se cili prej specifikimeve teknike nuk përmbushet nga artikujt/detergjentet e dorëzuar nga ana e tij. Në këtë kuptim, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar së cila nga specifikimet nuk përmbushet nga detergjentet (srt.23 dhe art.24) të dorëzuar, KPP e gjen arsyen e skualifikimit të ankimuesit të pabazuar dhe gjykon, se ankimuesi ka përmbushur kërkesat në kriterin e veçantë të kualifikimit duke dorëzuar mostrën përkatëse. Është detyrë e zyrtarëve përgjegjës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të pasqyrojnë në SPE vlerësimin e tyre, në mënyrë të qartë, konkrete dhe të kuptueshme. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, (shiko Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo) ka konkluduar, se shkaqet e skualifikimit duhet të përcaktohen qartësisht dhe të publikohen paraprakisht në kohë të mjaftueshme, me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të njihen me këto shkaqe. GJED në vendimin e mësipërm ka konfirmuar, se “përcaktim qartësisht” i shkaqeve të skualifikimit, do të thotë që të garantohet se ofertuesit janë njohur me kërkesat specifike procedurale dhe që të njëjtat kërkesa, aplikohen njëlloj për të gjithë ofertuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shkeljet e mësipërme, cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “W.Center” ShPK mbi skualifikimin e tij ekonomike arsyen se *“Skedat teknike për produktet 16 dhe 26 nuk janë paraqitur në SPE..”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, pika 2.3.2 *“Kapaciteti teknik”*, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri*:*

***2.3.2*** *Operatori ekonomik ofertues duhet të para**<u>gesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për produktet objekt prokurimi të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it ose distributori/ët zyrtarë.</u>** **<u>Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.</u>***

III.3.2. Në shtojcën 5, *"Formulari i Specifikimeve Teknike"*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

**Skicimet, parametrat teknik etj:**

| | |
|---|---|
| 1 | **Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete.**<br>Përbërja kimike: acid fosforik (10-20%) (CAS-Nr: 7664-38-2); isotridecylalkohol-ethoxylaten (<5%) (CAS-Nr: 9043-30-5), butoxy-ethanol (1-5%) (CAS-Nr: 111-76-2) ose ekuivalentet e tyre.<br>**Të dhëna teknike:**<br>Densiteti: 2 ± 0.3 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 1-1.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Përmbajtja e lëndëve tensioaktive: jo më pak se 8%.<br>Paketimi: në bidon plastik 0.5 deri 1 litra me mekanizem sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |

| | |
|---|---|
| 2 | **Fshesa merimangash me bisht të gjatë.** Koka te jete ne forme bohçe me fije plastike polietilen ose ekuivalent me diameter te jashtem 30-40cm. Gjatesia e fijeve 80-100 mm. Filetimi konik ose cilindrik me materiali polipropilen ose ekuivalent. Te kete bisht teleskopik me 2 ose 3 hapje dhe me gjatesi 200-250 cm. Materiali i bishtit metal i plastifikuar ose duralumin. Fileto konike ose cilindrike prej materiali polipropilen ose ekuivalentin e tij dhe te perputhen filetot e bishtit me ato te kokes plastike ne forme bohçe. |
| 3 | **Fshesa pastrimi me fije te gjata pa bisht.** Me fije te dendura dhe te buta. Me fileto per montimin e bishtit, material PVC. Bazamenti per mbajtjen e fijeve te pastrimit te jete i gjere 3-5 cm dhe me gjatesi 25 -30 cm. Materiali i fijes plastik PVC ose ekuivalent. Gjatesia e fijes 10-12 cm me dendesi jo me pak se 3500 fije. Filetot e fsheses te perputhen me ato te bishtit te ofertuar. |
| 4 | **Bishta te gjate per fshesa dhe shtupa**. Bishti te sherbeje per perdorim profesional dhe materiali i bishtit te jete perbere prej duaralumini ose metali te plastifikuar/me lyerje antikorrozive, ne forme tubi me diameter 24-26 mm dhe spesor 1-1.5 mm. Fileto e bishtit te jene konike ose cilindrike dhe te perputhen me filetimin e shtupes dhe te fsheses. Gjatesia e bishtit te jete 130-140 cm. Filetot e bishtit te perputhen me ato te fsheses te ofertuar. |
| 5 | **Fshese pastrimi territori me melakuq te dendur**. Duhet te jete profesionale me fije te dendura dhe me bisht druri ose metali/duralumini me gjatesi 100 -120cm dhe diameter 22-25mm. Gjatesi totale me gjithe fshese 140-160 cm. Bishti të jetë i kapur me fshesën, ne menyre te fabrikuar. Gjatësia e fijeve të fshesës 40-50cm, gjeresia e hapjes se fijeve ne fund te fsheses te jete 35-45 cm me trashësi 5-8 cm. |
| 6 | **Furçe pastrimi per WC me mbajtese.** Duhet te jete profesionale me fibra sintetike ne forme bohçe me diameter te jashtem 6-10 cm, me bisht te gjate 25-35 cm dhe e kompletuar me mbajtesen e furçes. Furça te jete me kapak te inkorporuar qe te perputhet plotesisht me mbajtesen e furçes. Mbajtesja e furçes te jete e perbere me material Polipropilen ose ekuivalent dhe te perputhet plotesisht me furçen dhe kapakun e saj. |
| 7 | **Kaci per mbledhjen e mbeturinave.** Kacia duhet te jete per perdorim profesional me depozite mbeturinash te inkorporuar me volum 2-3litra. Duhet te jete material polipropilen ose ekuivalent me bisht metalik te plastifikuar ose duralumini 80-100 cm te gjate. Tehu i kacise te jete me gjeresi 25-30 cm. |
| 8 | **Kosha plastik per mbeturina i vogel**. Koshi i mbeturinave per perdorim te brendshem duhet te jete me volum 8-10 litra, me thellesi 25 ± 5cm, gjeresi 25 ± 5cm x 18 ± 5cm (pa perfshire kapakun). Materiali te jete Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |

| | |
|---|---|
| 9 | **Kosha plastik per mbeturina i mesëm**. Koshi i mbeturinave per perdorim te brendshem duhet te jete me volum 14-16 litra, me thellesi 35 ± 5cm, gjeresi 30 ± 5cm x 25 ± 5cm cm (pa perfshire kapakun). Materiali te jete Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 10 | **Kosha plastik per mbeturina i madh**. Koshi i mbeturinave per perdorim te jashtem duhet te jete me kapacitet 60-70 Litra, me thellesi 60 ± 5cm gjeresi 50 ± 5cm x 40 ± 5cm cm (pa perfshire kapakun), materiali Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 11 | **Kosh plastik për mbeturina me rrota**. Koshi të ketë të montuara jo më pak se dy rrota për spostimin e tij nga një vend ne tjetrin. Duhet të jetë me kapacitet 100-120 Litra, me dimensione 50 ± 10cm x 60 ± 10cm x 100 ± 10cm, material Polipropilen (PP), kapaku të ketë dorezë për kapje dhe të lëvizë me anë të menteshave të kapura në trupin e koshit për hapje dhe mbyllje. Të jetë në përputhje me standartin shqiptar SSH EN 840-1:2012 ose ekuivalentin e tij. |
| 12 | **Kova larje me shtrydhese komplet**. Kova per pastrim/larje me mekanizem per shtrydhese ku mekanizmi i shtrydhjes te jete i çmontueshem lehtesisht. Kova duhet te jete me volum 16 -18 litra ku ne trupin e koves te jene te stampuara ndarja ne litra nga jo me pak se nje liter per ndarje. Te jete e perbere nga materiali Polipropilen ose ekuivalenti i tij, te kete doreze plastike per mbajtje dhe buze per derdhjen e ujit. |
| 13 | **Mekanizem shtrydhes (rezervë) per kova larje.** Te jete material i forte polipropilen ose ekuivalenti i tij dhe t`i pershtatet kovave të larjes objekt prokurimi (produkti me nr.13) duke u montuar dhe çmontuar lehtesisht. |
| 14 | **Pecete pastrimi mikrofiber**. Peceta te jete e pershtatshme per pastrimin e siperfaqeve te ndryshme. Me permasa 40 ± 10 cm x 40 ± 10 cm, me siperfaqe te pergjithshme jo me pak se 1500 $cm^2$, materiali te jete i perbere nga jo me pak se 80 ± 10 % poliester dhe nga 20 ± 5 % poliamyde, me peshe specifike jo me pak se 200 $g/m^2$. Paketimi ne plasmas ose karton ne jo me shume se dy cope per paketim. |
| 15 | **Leter higjenike per WC**. Leter higjenike per perdorim profesional me paketim mini jumbo. Te jete e perbere nga celuloze e paster me minimumi 2 shtresa dhe peshe specifike jo me pak se 15$g/m^2$. Gjatesia e letres se rulonit 140-160 metra. Gjeresia e letres 9-10 cm. Diametri i jashtëm i rulonit të jetë 60-75 cm. Diametri i brendshëm i rulonit të jetë 19-20 cm. Paketimi ne pako me 6-12 rulona me plasmas ose karton. |

| | |
|---|---|
III.4.9. Komisioni Prokurimit Publik referuar arsyes së skualifikimit të cituar në raport audit nga komisioni i vlerësimit të ofertave si dhe pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi vëren, se ankimuesi ka paraqitur në përputhje me kriterin e kërkuar skedat teknike të cilat referuar arsyes së skualifikimit ka qenë objekt-shqyrtimi nga KVO e autoritetit kontraktor. Por KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues "W. Center" SHPK dhe skualifikimin e tij, nuk e ka bërë në përputhje me vetë kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, duke skualifikuar operatorin ekonomik ankimues "W. Center" SHPK në mënyrë abuzive dhe të paargumentuar, pa përcaktuar se cilën nga specifikimet teknike të përcaktuara në DST e procedurës të përcaktuara nga autoriteti kontrtaktor nuk përmbush artikujt nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 21, 22 të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues "W.Center" SHPK. Gjykojmë, se ashtu sikurse është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet tekniko-ligjore në lidhje me përmbushjen e kriterit konkret, si dhe të specifikimeve teknike të kërkuara, edhe autoriteti kontraktor (komisioni vlerësimit të ofertave) ka barrën e provës të vërtetojë dhe argumentojë, se cilin nga specifikimet teknike nuk përmbushin artikujt (referuar skedave teknike) të dorëzuara duke mirëargumentuar edhe mosplotësimin e tyre. Bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", barra e provës në rastin konkret për vërtetueshmërinë e pretendimit (arsyes së skualifikimit), i takonte komisionit të vlerësimit të ofertave të identifikonte në mënyrë të saktë dhe të qartë, se cilin nga specifikimet teknike nuk përmbushte artikujt (nr.2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 21, 22) të dorëzuar duke dhënë argumentet mbi këtë fakt, i cili në rastin konkret ka dështuar t'i evidentojë dhe t'i argumentojë. Nuk mund të lejohet skualifikimi i një operatori ekonomik, në rast se ai ka plotësuar kriterin duke dorëzuar skedat teknike të kërkuara, për sa kohë që vetë autoriteti kontraktor, i cili ka vlerësuar ofertën e tij, nuk ka evidentuar në mënyrë të qartë se cilën nga specifikimet teknike të përcaktuara në DST e procedurës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor nuk përmbush artikujt e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues. Në këtë kuadër KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit, e pasqyruar në raport-audit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave se: *"Skedat teknike të paraqitura për produktet nr.2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 21, 22 nuk kanë të pasqyruara kërkesat teknike të kërkuara në DST,* është abuzive dhe e paargumentuar. KPP gjykon, se vetë autoriteti kontraktor ka kërkuar, që *operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për produktet objekt prokurimi të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/it ose distributori/ët zyrtarë. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.* Në rastin konkret ankimuesi ka provuar se sipas tij përmbush kriterin e përcaktuar më sipër me dorëzimin e skedave teknike për nr. 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 21, 22*"*, dhe i mbetej KVO-së së autoritetit kontraktor që në mbështetje të arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues "W.Center" SHPK të argumentonte, se

cili prej specifikimeve teknike nuk përmbushet nga artikujt e dorëzuar nga ana e tij. Në këtë kuptim, për sa kohë autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar së cila nga specifikimet nuk përmbushet nga artikujt nr.2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 21, 22 të dorëzuar, KPP e gjen arsyen e skualifikimit të ankimuesit të pabazuar dhe gjykon, se ankimuesi ka përmbushur kërkesat në kriterin e veçantë të kualifikimit duke dorëzuar mostrën përkatëse. Është detyrë e zyrtarëve përgjegjës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të pasqyrojnë në SPE vlerësimin e tyre, në mënyrë të qartë, konkrete dhe të kuptueshme. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, (shiko Çështjen C-27/15 Pippo Pizzo) ka konkluduar, se shkaqet e skualifikimit duhet të përcaktohen qartësisht dhe të publikohen paraprakisht në kohë të mjaftueshme, me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të njihen me këto shkaqe. GJED në vendimin e mësipërm ka konfirmuar, se "përcaktim qartësisht" i shkaqeve të skualifikimit, do të thotë që të garantohet se ofertuesit janë njohur me kërkesat specifike procedurale dhe që të njëjtat kërkesa, aplikohen njëlloj për të gjithë ofertuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se shkeljet e mësipërme, cenojnë në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se "*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*". Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "W.Center" SHPK qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "W.Center" ShPK mbi skualifikimin e tij ekonomike arsyen se *"Produktet e ofruara me nr.17, 18, 19, 20 nuk plotësojnë Standardin Teknik të kërkuar SSH EN 13432:2005 të kërkuar në DST për qese plastike të biodegradueshme."* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 *"Kriteret e veçanta të kualifikimit"*, pika 2.3.2 *"Kapaciteti teknik"*, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri*:*

***2.3.2*** *Operatori ekonomik ofertues duhet të para**qesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për produktet objekt prokurimi të lëshuara/publikuara***

***nga prodhuesi/it ose distributori/ët zyrtarë. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përkasin. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.***

III.5.2. Në shtojcën 5, *"Formulari i Specifikimeve Teknike"*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

**Skicimet, parametrat teknik etj:**

| | |
|---|---|
| 1 | **Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete.**<br>Përbërja kimike: acid fosforik (10-20%) (CAS-Nr: 7664-38-2); isotridecylalkohol-ethoxylaten (<5%) (CAS-Nr: 9043-30-5), butoxy-ethanol (1-5%) (CAS-Nr: 111-76-2) ose ekuivalentet e tyre.<br>**Të dhëna teknike:**<br>Densiteti: 2 ± 0.3 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 1-1.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Përmbajtja e lëndëve tensioaktive: jo më pak se 8%.<br>Paketimi: në bidon plastik 0.5 deri 1 litra me mekanizem sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |

| | |
|---|---|
| 2 | **Fshesa merimangash me bisht të gjatë.** Koka te jete ne forme bohçe me fije plastike polietilen ose ekuivalent me diameter te jashtem 30-40cm. Gjatesia e fijeve 80-100 mm. Filetimi konik ose cilindrik me materiali polipropilen ose ekuivalent. Te kete bisht teleskopik me 2 ose 3 hapje dhe me gjatesi 200-250 cm. Materiali i bishtit metal i plastifikuar ose duralumin. Fileto konike ose cilindrike prej materiali polipropilen ose ekuivalentin e tij dhe te perputhen filetot e bishtit me ato te kokes plastike ne forme bohçe. |
| 3 | **Fshesa pastrimi me fije te gjata pa bisht.** Me fije te dendura dhe te buta. Me fileto per montimin e bishtit, material PVC. Bazamenti per mbajtjen e fijeve te pastrimit te jete i gjere 3-5 cm dhe me gjatesi 25 -30 cm. Materiali i fijes plastik PVC ose ekuivalent. Gjatesia e fijes 10-12 cm me dendesi jo me pak se 3500 fije. Filetot e fsheses te perputhen me ato te bishtit te ofertuar. |
| 4 | **Bishta te gjate per fshesa dhe shtupa**. Bishti te sherbeje per perdorim profesional dhe materiali i bishtit te jete perbere prej duaralumini ose metali te plastifikuar/me lyerje antikorrozive, ne forme tubi me diameter 24-26 mm dhe spesor 1-1.5 mm. Fileto e bishtit te jene konike ose cilindrike dhe te perputhen me filetimin e shtupes dhe te fsheses. Gjatesia e bishtit te jete 130-140 cm. Filetot e bishtit te perputhen me ato te fsheses te ofertuar. |
| 5 | **Fshese pastrimi territori me melakuq te dendur**. Duhet te jete profesionale me fije te dendura dhe me bisht druri ose metali/duralumini me gjatesi 100 -120cm dhe diameter 22-25mm. Gjatesi totale me gjithe fshese 140-160 cm. Bishti të jetë i kapur me fshesën, ne menyre te fabrikuar. Gjatësia e fijeve të fshesës 40-50cm, gjeresia e hapjes se fijeve ne fund te fsheses te jete 35-45 cm me trashësi 5-8 cm. |
| 6 | **Furçe pastrimi per WC me mbajtese.** Duhet te jete profesionale me fibra sintetike ne forme bohçe me diameter te jashtem 6-10 cm, me bisht te gjate 25-35 cm dhe e kompletuar me mbajtesen e furçes. Furça te jete me kapak te inkorporuar qe te perputhet plotesisht me mbajtesen e furçes. Mbajtesja e furçes te jete e perbere me material Polipropilen ose ekuivalent dhe te perputhet plotesisht me furçen dhe kapakun e saj. |
| 7 | **Kaci per mbledhjen e mbeturinave.** Kacia duhet te jete per perdorim profesional me depozite mbeturinash te inkorporuar me volum 2-3litra. Duhet te jete material polipropilen ose ekuivalent me bisht metalik te plastifikuar ose duralumini 80-100 cm te gjate. Tehu i kacise te jete me gjeresi 25-30 cm. |
| 8 | **Kosha plastik per mbeturina i vogel**. Koshi i mbeturinave per perdorim te brendshem duhet te jete me volum 8-10 litra, me thellesi 25 ± 5cm, gjeresi 25 ± 5cm x 18 ± 5cm (pa perfshire kapakun). Materiali te jete Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |

| | |
|---|---|
| 9 | **Kosha plastik per mbeturina i mesëm**. Koshi i mbeturinave per perdorim te brendshem duhet te jete me volum 14-16 litra, me thellesi 35 ± 5cm, gjeresi 30 ± 5cm x 25 ± 5cm cm (pa perfshire kapakun). Materiali te jete Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 10 | **Kosha plastik per mbeturina i madh**. Koshi i mbeturinave per perdorim te jashtem duhet te jete me kapacitet 60-70 Litra, me thellesi 60 ± 5cm gjeresi 50 ± 5cm x 40 ± 5cm cm (pa perfshire kapakun), materiali Polipropilen ose ekuivalenti i tij, ku kapaku te jete i çmontueshem dhe te hapet mekanikisht duke realizuar mbylljen automatikisht me lekundje pas derdhjes se mbeturinave. |
| 11 | **Kosh plastik për mbeturina me rrota**. Koshi të ketë të montuara jo më pak se dy rrota për spostimin e tij nga një vend ne tjetrin. Duhet të jetë me kapacitet 100-120 Litra, me dimensione 50 ± 10cm x 60 ± 10cm x 100 ± 10cm, material Polipropilen (PP), kapaku të ketë dorezë për kapje dhe të lëvizë me anë të menteshave të kapura në trupin e koshit për hapje dhe mbyllje. Të jetë në përputhje me standartin shqiptar SSH EN 840-1:2012 ose ekuivalentin e tij. |
| 12 | **Kova larje me shtrydhese komplet**. Kova per pastrim/larje me mekanizem per shtrydhese ku mekanizmi i shtrydhjes te jete i çmontueshem lehtesisht. Kova duhet te jete me volum 16 -18 litra ku ne trupin e koves te jene te stampuara ndarja ne litra nga jo me pak se nje liter per ndarje. Te jete e perbere nga materiali Polipropilen ose ekuivalenti i tij, te kete doreze plastike per mbajtje dhe buze per derdhjen e ujit. |
| 13 | **Mekanizem shtrydhes (rezervë) per kova larje.** Te jete material i forte polipropilen ose ekuivalenti i tij dhe t`i pershtatet kovave të larjes objekt prokurimi (produkti me nr.13) duke u montuar dhe çmontuar lehtesisht. |
| 14 | **Pecete pastrimi mikrofiber**. Peceta te jete e pershtatshme per pastrimin e siperfaqeve te ndryshme. Me permasa 40 ± 10 cm x 40 ± 10 cm, me siperfaqe te pergjithshme jo me pak se 1500 $cm^2$, materiali te jete i perbere nga jo me pak se 80 ± 10 % poliester dhe nga 20 ± 5 % poliamyde, me peshe specifike jo me pak se 200 $g/m^2$. Paketimi ne plasmas ose karton ne jo me shume se dy cope per paketim. |
| 15 | **Leter higjenike per WC**. Leter higjenike per perdorim profesional me paketim mini jumbo. Te jete e perbere nga celuloze e paster me minimumi 2 shtresa dhe peshe specifike jo me pak se 15$g/m^2$. Gjatesia e letres se rulonit 140-160 metra. Gjeresia e letres 9-10 cm. Diametri i jashtëm i rulonit të jetë 60-75 cm. Diametri i brendshëm i rulonit të jetë 19-20 cm. Paketimi ne pako me 6-12 rulona me plasmas ose karton. |

| | |
|---|---|
| 16 | **Mekanizem mbajtes dhe shperndares per letrat higjenike të ËC (dispencer).** Te jete i pershatshem per perdorim profesional ne tualete. Lloji i letres higjenike te perdorur do te jete paketim minijumbo me kerkesat teknike te paraqitura per produktin ne piken 15 te kesaj tabele. Te jete me material polipropilen ose ekuivalenti i tij, Te kete dritare per te mundesuar monitorimin e konsumit te letres higjenike. Dispenceri te hapet dhe te mbyllet me nje mekanizem (çeles) te veçante per te parandaluar shperdorimin e letres higjenike. |
| 17 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 35 ± 5cm x 35± 5cm, 30-40 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar **SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij**. |
| 18 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 50 ± 5cm x 60± 5cm, 40-50 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar **SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij.** |
| 19 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 60 ± 10cm x 80 ± 10cm, 70-80 litra, trashesia 20-30 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar **SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij.** |
| 20 | **Qese mbeturinash** per koshat, me permasa 80 ± 10cm x 100± 10cm, volumi 100-120 litra, trashesia 30-40 micron, te jete e paketuar ne 10-20 copë, te biodegradueshme dhe prodhuar sipas standartit shqiptar **SSH EN 13432:2005 ose ekuivalentin e tij.** |
| 21 | **Shtupa per larje dyshemeje.** Bazamenti i shtupës per montimin e bishtit te jete prej polipropileni ese ekuivalenti i tij me fileto cilindrike ose konike, materiali i shtupes te jete i perbere nga jo me pak se 80 ± 10 % poliester dhe nga 20 ± 5 % poliamyde, me peshe specifike jo me pak se 200 g/m², gjatesia e fijes 35 ± 5 cm. Filetot e shtupës te perputhen me ato te bishtit te ofertuar. Pesha e produktit 200-300gr. |
| 22 | **Sfungjer per larjen e aksesoreve hidrosanitarë.** Permasat Gjatesia 150 ± 10 mm x Gjeresia 80 ± 10mm x Trashesia 35 ± 5 mm, me material sfungjerik sintetik ku materiali i ashpersuar te jete me trashesi 5-7 mm. Material te jete poroz që nuk lejon zhvillimin e baktereve, dhe të ketë jetëgjatësi. Paketimi ne qese plastike ose karton me 2-6 cope dhe sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. |

| | |
|---|---|
| 23 | **Detergjent i përqendruar për larjen e dyshemese.**<br>Perberja kimike: Tensioaktivë kationikë ≤ 5%, tensioaktivë jo-jonikë ≤ 5%. Të ketë në përbërje të paktën një lëndë dezinfektuese nga komponime të amoniumit kuaternar.<br>Të dhëna teknike:<br>Densiteti: 1 ± 0.1 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 7 ± 0.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Paketimi: në bidona plastik 1 deri në 5 litër sipas kërkesave të autoritetit kontraktorë. |
| 24 | **Detergjent per larje xhamash.**<br>Perberja kimike: 2-Butoxyethanol (5-10%) (CAS-Nr: 111-76-2). Te miratuara sipas normativave te databazes se ECHA dhe direktivave te BE.<br>Te dhena teknike:<br>Densiteti: 1 ± 0.1 gr/cm3.<br>Përmbajtja e joneve [H+]: 11-11.5 pH;<br>Biodegradueshmeria: jo më pak se 80%, sipas rregullores (KE) nr. 648/2004 mbi detergjentët.<br>Përmbajtja e lëndëve tensioaktive: <8%<br>Paketimi në bidon plastik 0.5 deri ne 1 litër me mekanizëm sprucimi dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. |
| 25 | **Letra per fshirje e duarve e palosur z/v-Fold.** Leter higjenike duarsh per perdorim profesional me paketim z/v fold. Te jete e perbere nga celuloze e paster me minimumi 2 shtresa dhe peshe specifike jo me pak se 15g/m². Pakoja te permbaje jo me pak se 200 fije. Gjeresia e paketimit 10.5 ± 0.5 cm. Gjatesia e paketimit 21.5 ± 0.5 cm. Paketimi ne pako me jo me pak se 200 fije me pasmas ose karton. Ngjyre e bardhe. |
| 26 | **Mekanizem mbajtes dhe shperndares per letrat higjenike te duarve (dispencer)**. Te jete i pershatshem per perdorim profesional ne tualete. Lloji i letres higjenike te perdorur do te jete me paketim z/v Fold ne perputhje me kerkesat teknike te paraqitura per produktin ne piken 25 te kesaj tabele me kapacitet mbajtes jo me pak se 400 fije letre higjenike z/v Fold. Mekanizmi te jete me material polipropilen ose ekuivalenti i tij. Te kete dritare per te mundesuar monitorimin e konsumit te letres higjenike te duarve. Dispenceri te hapet dhe te mbyllet me nje mekanizem (çeles) te veçante per te parandaluar shperdorimin e letres higjenike. |

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

Mallrat do të lëvrohen të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontratë) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Të gjitha mallrat të cilat do të lëvrohen nga operatori ekonomik fitues duhet të jenë

patjetër konform ofertës teknike të ofruar dhe të depozituar duke përfshirë cilësitë teknike dhe markën e prodhuesit.

Furnizimi do të bëhet me mjetet teknike të furnizuesit në çdo objekt shkollor sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor në sasi, lloj dhe kohë brenda afatit të përcaktuar në çdo minikontratë të lidhur nga data e nëshkrimit. Lloji dhe sasia e mallrave objekt prokurimi që do të shpërndahen do të përcaktohen qartë nga Autoritetit Kontraktor për çdo objekt shkollor dhe parashkollor në planin e shpërndarjes i cili do të vihet në dispozicion të operatorit ekonomik fitues ditën e nënshkrimit të çdo minikontrate.

Të gjitha paketimet e mallrave objekt prokurimi duhet të jenë të etiketuara në gjuhën shqipe referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.669 datë 28.09.2011, "Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentët", dhe nenit 8 të Ligjit Nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve".

Ndërsa në shtojcën 6, *"Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit"*, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

**Shtojca 6**

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

| Nr. | Përshkrimi i mallrave | Njësia | Sasia e pritshme |
|---|---|---|---|
| 1 | Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete | litra | 14 715 |
| 2 | Fshesa merimangash me bisht të gjatë | copë | 182 |
| 3 | Fshesa pastrimi me fije të gjata pa bisht | copë | 918 |
| 4 | Bishta të gjatë për fshesa dhe shtupa | copë | 1 859 |
| 5 | Fshesë pastrimi territori me melakuqi të dendur | copë | 300 |
| 6 | Furçë pastrimi për WC me mbajtëse | copë | 975 |
| 7 | Kaci për mbledhjen e mbeturinave | copë | 849 |
| 8 | Kosh plastik për mbeturina i vogël | copë | 464 |
| 9 | Kosh plastik për mbeturina i mesëm | copë | 1 387 |
| 10 | Kosh plastik për mbeturina i madh | copë | 140 |
| 11 | Kosh plastik për mbeturina me rrota | copë | 148 |
| 12 | Kovë për larje me shtrydhëse komplet | copë | 848 |
| 13 | Mekanizëm shtrydhje (rezervë) për kovat e larjes | copë | 410 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **14** | Pecetë pastrimi mikrofibër | copë | **11 244** |
| **15** | Letër higjenike për WC | copë | **15 368** |
| **16** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të ËC | copë | **247** |
| **17** | Qese mbeturinash 30-35 litra | copë | **167 376** |
| **18** | Qese mbeturinash 50-60 litra | copë | **164 136** |
| **19** | Qese mbeturinash 70-80 litra | copë | **71 104** |
| **20** | Qese mbeturinash 100-120 litra | copë | **28 846** |
| **21** | Shtupë për larje dyshemeje | copë | **2 822** |
| **22** | Sfungjer për larjen e aksesorëve hidrosanitarë | copë | **15 229** |
| **23** | Detergjent për larjen e dyshemesë | litra | **49 077** |
| **24** | Detergjent për larjen e xhamave | litra | **2 177** |
| **25** | Letër higjenike për fshirjen e duarve z/v-Fold | pako | **67 558** |
| **26** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të duarve z/v Fold | copë | **247** |

**Grafiku i lëvrimit të mallit** do të njoftohet nga autoriteti kontraktor krahas çdo minikontrate që do të lidhet në zbatim dhe brenda afatit të marrëveshjes kuadër.

**Afatet e lëvrimit:**

| **Nr.** | **Përshkrimi i mallrave** | **Njësia** | **Sasia** | **Destinacioni** | **Periudha e dorëzimit** |
|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Detergjent i përqendruar për pastrim në tualete | litra | **14 715** | DPOP | 12 muaj |
| **2** | Fshesa merimangash me bisht të gjatë | copë | **182** | DPOP | 12 muaj |
| **3** | Fshesa pastrimi me fije të gjata pa bisht | copë | **918** | DPOP | 12 muaj |
| **4** | Bishta të gjatë për fshesa dhe shtupa | copë | **1 859** | DPOP | 12 muaj |
| **5** | Fshesë pastrimi territori me melakuqi të dendur | copë | **300** | DPOP | 12 muaj |
| **6** | Furçë pastrimi për WC me mbajtëse | copë | **975** | DPOP | 12 muaj |
| **7** | Kaci për mbledhjen e mbeturinave | copë | **849** | DPOP | 12 muaj |
| **8** | Kosh plastik për mbeturina i vogël | copë | **464** | DPOP | 12 muaj |
| **9** | Kosh plastik për mbeturina i mesëm | copë | **1 387** | DPOP | 12 muaj |
| **10** | Kosh plastik për mbeturina i madh | copë | **140** | DPOP | 12 muaj |
| **11** | Kosh plastik për mbeturina me rrota | copë | **148** | DPOP | 12 muaj |
| **12** | Kovë për larje me shtrydhëse komplet | copë | **848** | DPOP | 12 muaj |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **13** | Mekanizëm shtrydhje (rezervë) për kovat e larjes | copë | **410** | DPOP | 12 muaj |
| **14** | Pecetë pastrimi mikrofibër | copë | **11 244** | DPOP | 12 muaj |
| **15** | Letër higjenike për WC | copë | **15 368** | DPOP | 12 muaj |
| **16** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të WC | copë | **247** | DPOP | 12 muaj |
| **17** | Qese mbeturinash 30-35 litra | copë | **167 376** | DPOP | 12 muaj |
| **18** | Qese mbeturinash 50-60 litra | copë | **164 136** | DPOP | 12 muaj |
| **19** | Qese mbeturinash 70-80 litra | copë | **71 104** | DPOP | 12 muaj |
| **20** | Qese mbeturinash 100-120 litra | copë | **28 846** | DPOP | 12 muaj |
| **21** | Shtupë për larje dyshemeje | copë | **2 822** | DPOP | 12 muaj |
| **22** | Sfungjer për larjen e aksesorëve hidrosanitarë | copë | **15 229** | DPOP | 12 muaj |
| **23** | Detergjent për larjen e dyshemesë | litra | **49 077** | DPOP | 12 muaj |
| **24** | Detergjent për larjen e xhamave | litra | **2 177** | DPOP | 12 muaj |
| **25** | Letër higjenike për fshirjen e duarve z/v-Fold | pako | **67 558** | DPOP | 12 muaj |
| **26** | Mekanizëm mbajtës dhe shpërndarës për letrat higjenike të duarve z/v Fold | copë | **247** | DPOP | 12 muaj |

III.5.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik "W.Center" ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

***Dokumentin Catalogue Everest IE Finale (çertifikatat e cilësisë ISO 9001:2008, ISO 14001; ISO 14021; ISO 45001;)***

III.5.4. Neni 2 "Qëllimi i ligjit" 162/2021 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se: "*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik*".

Ndërkohë në neni 3 "Parime të përgjithshme" 162/2021 "*Për prokurimin publik*" parashikohet se: "*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur*

*prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën".*

Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 *"Kërkesat për kualifikim"* të ligjit 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*" parashikohet shprehimisht se:

*"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*
*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie"*

III.5.5. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*"1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.*

*2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

*3. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet,*

*mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

*b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.".*

III.5.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"*. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e specifikimeve të mallrave/shërbimeve të ofertuara prej tyre, me ato të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me specifikimet përkatëse të kërkuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.5.7. Komisioni i Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, vendosi në zbatim të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative si dhe nenit 24 e vijues të LPP-së me shkresën nr. 831/6prot datë 15.05.2023 me objekt "Kërkesë për informacion", ti drejtohet **Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit** në të cilën kërkoi konkretisht citojmë: *"[...]Aktualisht Komisioni është duke shqyrtuar një ankesë. Në ankesën objekt ankimi konsatojmë se nga operatori ekonomik në përmbushje të kritereve kualifikuese, është paraqitur produkt/artikull i certifikuar me ISO 14001, ISO 14021, ISO 45001 ndërsa në dokumentet e tenderit të procedurës objekt prokurimi është kërkuar produkt/artikull e konkretisht*

*art. Qese mbeturinash  të biodegradueshme  dhe të prodhuara sipas standardit shqiptar SSH EN 13432:2005. Lidhur me këtë fakt, Komisioni kërkon nga ana juaj si institucion kompetent, një informacion nëse standardi i certifikimit ISO 14021 është i barasvlershëm me standardin e certifikimit SSH EN 13432:2005.[...]"*

III.5.8. Me shkresën nr. 272/1prot. datë 17.05.2023 protokolluar me tonën nr. 831/8prot. datë 22.05.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit na informon konkretisht citojmë: *"[...] Të dy standardet e përmendur nuk janë standarde që përdoren në procedurat e akreditimit. Për sa i takon informacionit mbi barazvlefshmërinë midis dy standardeve, mendojmë se ju duhet ti drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit e cila është organizimi kombëtar i standardeve në Shqipëri. Për sa i takon certifikimit sipas këtyre dy standardeve ju informojmë që në kuptim të DPA: Standardi ISO 14021:2016 Etiketat dhe deklaratat mjedisore –Pretendimet mjedisore të vetëdeklaruara (etiketimi mjedisor i tipit II) specifikohen kërkesat për pretendimet mjedisore të vetëdeklaruara nga kompania për produktet e saj. Certifikimi sipas këtij standardi demonstron konformitetin e vetë-deklarimeve mbi pretendimin mjedisor përkatës me kërkesat e standardit ISO 14021. Standardi S SHEN 13432:2005 "Ambalazhimi –Kërkesat për ambalazhimin nëpërmjet kompostimit dhe biodegradimit –Skema e provave kriteret e vlerësimit për pranimin përfundimtar të ambalazhimit specifikon kërkesat dhe procedurat për të përcaktuar kompostueshmërinë dhe përpunueshmërinë anaerobe të paketimit të materialeve të paketimit duke adresuar katër karakteristika: 1) biodegradueshmërinë; 2) shpërbërja gjatë trajtimit biologjik; 3) efekt në procesin e trajtimit biologjik; 4) efekt në cilësinë e kompostit që rezulton . Certifikimi sipas këtij standardi demonstron konformitetin e produktit me kërkesat S SH EN 13432:2005. [...]"*

III.5.9. Gjithashtu me shkresën nr. 831/9prot datë 23.03.2023 me objekt "Kërkesë për informacion", Komisioni i Prokurimit Publik i'u drejtua **Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit** në të cilën kërkoi konkretisht citojmë: *"[...]Aktualisht Komisioni është duke shqyrtuar një ankesë. Në ankesën objekt ankimi konstatojmë se nga operatori ekonomik në përmbushje të kritereve kualifikuese, është paraqitur produkt/artikull i certifikuar me ISO 14001, ISO 14021, ISO 45001 ndërsa në dokumentet e tenderit të procedurës objekt prokurimi është kërkuar produkt/artikull e konkretisht art. Qese mbeturinash të biodegradueshme dhe të prodhuara sipas standardit shqiptar SSH EN 13432:2005. Lidhur me këtë fakt, Komisioni kërkon nga ana juaj si institucion kompetent, një informacion nëse standardi i certifikimit ISO 14021 është i barasvlershëm me standardin e certifikimit SSH EN 13432:2005.[...]"*

III.5.10. Me shkresën nr145/1prot. datë 29.05.2023 protokolluar me tonën nr. 831/10prot. datë 31.05.2023 Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit na informon konkretisht citojmë: "[...]Bazuar në shkresën tuaj me nr.83 1/9 Prot, date 23.05.2023 "Kërkesë për informacion" protokolluar me tonën me nr. 145, date 25.05.2023, ju informojmë se: *"[...]1. Standardi ISO 14021 "Etiketat mjedisore dhe Deklaratat - Vetëdeklarimet mbi Pretendimet Mjedisore (Tipi II Etiketimi mjedisor) specifikon kërkesat për pretendimet ne vetedeklarimet mjedisore, duke perfshire deklaratat, simbolet dhe grafikat, ne lidhje me produktet. Ai pershkruan me tej termat e zgjedhur qe perdoren në pretendimet mjedisore dhe jep mënyrat/specifikimet per perdorimin e tyre. Ky Standard Ndërkombetar pershkruan gjithashtu, nje metodologji te pergjithshme vlerësimi dhe*

*verifikimi per pretendimet e vetëdeklaruara mjedisore dhe metodat specifike te vleresimit he verifikimit per secilin nga vetëdeklarimet e trajtuara ne kete Standard.*

*2. Standardi SSH EN 13432:2005 "Paketimi - Kerkesat për paketim te riciklueshëm pêrmes dekompozimit dhe biodegradimit - Skema e testimit dhe kriteret e vlerësimit per pranimin perfundimtar te paketimit" specifikon kerkesat dhe procedurat per percaktimin e trajtimit te dekompozimit (anaerobe) te paketimit dhe materialeve te paketimit, duke trajtuar katër karakteristikat e mëposhtëme:1. Biodegradueshmërine,2. shpërbërjen gate trajtimit biologjik, 3. efekti ne procesin e trajtimit biologjik, 4. efekt ne cilësine e kompostit që rezulton[...]"*

III.5.11. Referuar korrespondencës sa më sipër, KPP vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik për produktet nr. 17, 18, 19, 20., (shih: Shtojcës 5 e shtojcës 6 në dt.) të cilat sipas përcaktimit në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-shqyrtimi duhet të plotësojnë standardin SSH EN 13432:2005*"*, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm pasi Drejtoria e Përgjithshme të Standardizimit (DPS), si institucion përgjegjës për standardizimin na informon se konkretisht citojmë: *"[...]1.Standardi ISO 14021 "Etiketat mjedisore dhe Deklaratat - Vetëdeklarimet mbi Pretendimet Mjedisore (Tipi II Etiketimi mjedisor) specifikon kerkesat per pretendimet ne vetedeklarimet mjedisore, duke perfshire deklaratat, simbolet dhe grafikat, ne lidhje me produktet. Ai pershkruan me tej termat e zgjedhur qe perdoren në pretendimet mjedisore dhe jep mënyrat/specifikimet per perdorimin e tyre. Ky Standard Ndërkombetar pershkruan gjithashtu, nje metodologji te pergjithshme vlerësimi dhe verifikimi per pretendimet e vetëdeklaruara mjedisore dhe metodat specifike te vleresimit he verifikimit per secilin nga vetëdeklarimet e trajtuara ne kete Standard.*

*2. Standardi SSH EN 13432:2005 "Paketimi - Kerkesat për paketim te riciklueshëm pêrmes dekompozimit dhe biodegradimit - Skema e testimit dhe kriteret e vlerësimit per pranimin perfundimtar të paketimit" specifikon kerkesat dhe procedurat per percaktimin e trajtimit te dekompozimit (anaerobe) te paketimit dhe materialeve te paketimit, duke trajtuar katër karakteristikat e mëposhtëme:1. Biodegradueshmërine,2. shpërbërjen gate trajtimit biologjik, 3. efekti ne procesin e trajtimit biologjik, 4. efekt ne cilësine e kompostit që rezulton[...]"*

Për sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në kushtet kur Drejtoria e Përgjithshme të Standardizimit (DPS), për sa i takon informacionit mbi barazvlefshmërinë e standardit të sipërcituar na informon se standardi ndërkombëtar **ISO 14021** specifikon kërkesat për pretendimet në vetëdeklarimet mjedisore, duke përfshire deklaratat, simbolet dhe grafikat, në lidhje me produktet, ndërsa standardi **SSHEN 13432:2005**. Skema e testimit dhe kriteret e vlerësimit për pranimin përfundimtar të paketimit specifikon kërkesat dhe procedurat për përcaktimin e trajtimit të dekompozimit (anaerobe) të paketimit dhe materialeve të paketimit, duke trajtuar katër karakteristikat e mëposhtëme:1. Biodegradueshmërine,2. shpërbërjen gjatë trajtimit biologjik, 3. efekti në procesin e trajtimit biologjik, 4. efekt në cilësinë e kompostit që rezulton.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në

përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në këtë kuadër Komisioni, KPP gjykon se operatori ekonomik "W.Center" SHPK me dokumentacionin e paraqitur, nuk arrin të provojë se disponon të furnizojë autoritetin kontraktor me produktet /artikujt **qese mbeturinash të biodegradueshme** dhe të prodhuara sipas standardit të certifikimit SSH EN 13432:2005 referuar specifikimit teknik të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-shqyrtimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik*", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik "Malvina Visoka" PF në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr. REF-56894-01-25-2023 me objekt "Blerje materiale pastrimi" me fond limit 39 999 986 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) Leke, pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik "W.Center" SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik "Malvina Visoka" PF dhe operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK duke i kualifikuar këta operatorë ekonomikë, si dhe të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik "W.Center" SHPK.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë "Malvina Visoka" PF, operatorit ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK dhe operatorit ekonomik "W.Center" SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëher.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| | | |
|---|---|---|
| **Nënkryetar** | **Anëtar** | **Anëtar** |
| **Fiorent Zguro** | **Kreshnik Ternova** | **Anila Malaj** |

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**

Digitally signed by
Jonaid MYZYRI
Date: 2023.06.02
03:46:40

Vulosur elektronikisht nga Komisioni i
Prokurimit Publik
Date:2023/06/02 13:31:14 +02'00'
6422852023060213310447020



*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë*
*të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Komisioni i Prokurimit Publik)*